

## ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

*Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092*

Një ankesë kundër: **KUVENDI KOMUNAL FUSHË KOSOVË**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **612-26-4427-5-1-1**

Sa i përket tenderit për **Asfaltimi i rrugës Pajazit Islami në Fushë Kosovë me infrastrukturë përcjellëse- projekt dy vjeçar**

### ANKESË

#### 1. Identifikimi i ankuesit\*

|                                                |                                    |
|------------------------------------------------|------------------------------------|
| Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj          | <b>" A &amp; S GROUP " SH.P.K.</b> |
| NUI                                            | <b>810059940</b>                   |
| Adresa                                         | <b>Rr. Bill Klinton</b>            |
| Vendi                                          | <b>Prishtinë</b>                   |
| Kodi postar                                    | <b>10000</b>                       |
| Numri Telefonit                                |                                    |
| Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj | <b>Avni Gjoka</b>                  |
| Adresa elektronike                             | <b>asgroupshpk@gmail.com</b>       |
| Data e parashtrimit të ankesës                 | <b>20.07.2026</b>                  |

*\*Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*



#### 2. Identifikimi i avokatit

*Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.*

*Shëno të dhënat si në vijim:*

Emri i avokatit  
Adresa e plotë  
Numri i Telefonit  
Numri i faks-it  
Adresa elektronike

### 3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës” “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit”, apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Ankesa i përket grupeve:

**Asfaltimi i rrugës Pajazit Islami në Fushë Kosovë me infrastrukturë përcjellëse-projekt dy vjecar**

**B05 Njoftim per Kontrat 08.06.2026**

**Kerkes per rishqyrtim 15.07.2026**

**16.07.2026 08:09 Kërkesë për rishqyrtim - Kerkes per Rishqyrtim-12.pdf**

### 4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐

Jo ☒

### 5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☐

Jo ☒

### 6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒

Jo ☐

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontestit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se.

**-Neni 7 - Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi (LPP)- kërkesat nuk duhet të favorizojnë apo diskriminojnë operatorë ekonomikë.**

**-Neni 51 - Kriteret e Përzgjedhjes LPP)- Parashikon që kriteret e përzgjedhjes duhet të jenë proporcionale, të lidhura me objektin e kontratës dhe të mos jenë më të rënda sesa është e nevojshme.**

**-Neni 52 - Njoftimi për Kriteret e Përzgjedhjes (LPP)- Kriteret duhet të jenë të qarta dhe të mos krijojnë paqartësi ose kufizime të panevojshme.**

## 7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

*Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie të Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.*

- Neni 1- Qëllimi (LPP)- Siguron përdorim efikas të fondeve publike dhe zhvillimin e konkurrencës.
- Neni 7 - Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi (LPP)- kërkesat nuk duhet të favorizojnë apo diskriminojnë operatorë ekonomikë.
- Neni 51 - Kriteret e Përzgjedhjes (LPP)- Parashikon që kriteret e përzgjedhjes duhet të jenë proporcionale, të lidhura me objektin e kontratës dhe të mos jenë më të rënda sesa është e nevojshme.
- Neni 52 - Njoftimi për Kriteret e Përzgjedhjes (LPP)- Kriteret duhet të jenë të qarta dhe të mos krijojnë paqartësi ose kufizime të panevojshme

*\*\* Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthejë tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjohë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.*

## 8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

*Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.*

Kundër njoftimit për Kontratë të AK-KOMUNA E FUSH KOSOVES të dt.08.06.2026, ne si OE. Te interesuar për te qene pjesëmarrës në aktivitetin e prokurimit Asfaltimi i rrugës Pajazit Islami në Fushë Kosovë me infrastrukturë përcjellëse- projekt dy vjecar. me nr.prok. 612-26-4427-5-1-1, në afatinë e paraparë ligjor parashtrojmë këtë kërkesë për Rishqyrtim dhe atë për shkak se Autoriteti kontraktues ka bërë shkelje të nenit 1,7,51,52, të LPP-së .

Si OE i interesuar për te qen pjesë marres ne këtë procedurë kem shpreh interesim për kompletim te dokumentacionit, duke par se AK Komuna e Fushkosoves ka vendosur kriteret diskriminuese, fillimisht ju kem drejtuar AK me kërkesë për sqarime duke kërkuar qe te hiqen apo te zëvendësohet disa prej kriterëve ne këtë procedurë. AK na u është përgjigjur Kërkesës ton dhe ka ber korrigjimin e dosjes duke hjekur disa prej kriterëve, mirëpo për këto te dyja nuk e ka marr parasysh kërkesën ton dhe nuk i ka trajtuar fare duke aluduar ne at se nuk janë kriteret diskriminuese

Një inxhinjer te diplomuar ne Inxhinjeri Ndertimore dhe Infrastrukture, specializim Menaxhim i Ndertimtaris dhe Teknologjis sistemin bachelor ose master, me min. 5 vite

pervoje pune pas diplomimit - i certifikuar nga ODA e Inxhinjereve te Kosoves  
-Një Mjeshter të Drenazhimit me min.3 vite pervoj pune pas diplomimit.

8. Një inxhinier te diplomuar ne Inxhinieri Ndërtimore dhe Infrastruktura, specializim Menaxhim i Ndërtimtarisë dhe Teknologjisë sistemin bachelor ose master, me min. 5 vite pervoj pune pas diplomimit - i certifikuar nga ODA e Inxhinjereve te Kosovës.

Kërkesa për një profil kaq specifik akademik nuk është arsyetuar nga Autoriteti Kontraktues.

Punimet mund të realizohen nga inxhinierë të ndërtimtarisë me profile të ndryshme që posedojnë licencën përkatëse dhe përvojën profesionale. Kufizimi vetëm në një drejtim të caktuar universitar përjashton operatorë ekonomikë që disponojnë staf me kompetenca ekuivalente. Andaj kërkojmë te largohet si kriter

Në përputhje me nenin 52 të LPP-së, kriteret duhet të jenë proporcionale dhe të lidhura drejtpërdrejt me realizimin e kontratës. AK me profilin shtesë -specializim me Menaxhim i Ndërtimtarisë dhe teknologjisë, ka favorizuar nje OE e I cili ketë specializim mund ta ketë ne ndonjë nga Universitetet Private, por I cili si profil nuk ka te bej fare me natyrën e punës ne ketë procedure.

Termi "specializim Menaxhim i Ndërtimtarisë dhe Teknologjisë" nuk është një profil standard që ekziston në të gjitha universitetet. Ai zakonisht i referohet një drejtimi ose moduli brenda programit të Inxhinierisë Ndërtimore, dhe jo një profesioni të veçantë. Pra, fokusi është më shumë në menaxhimin e procesit të ndërtimit, sesa në projektimin e strukturave, rrugëve, urave apo objekteve hidroteknike.

Autoriteti Kontraktues nuk mund të kufizojë pjesëmarrjen vetëm në një program studimi ose specializim të caktuar, kur ekzistojnë profile të tjera universitare që sigurojnë të njëjtat kompetenca profesionale. Në praktikën e prokurimit publik pranohet që kërkesat duhet të bazohen në kompetencat profesionale dhe jo në emërtimin specifik të programit universitar. Objekti i kontratës është, ndërtimi, rehabilitimi i rrugëve, infrastrukturës, atëherë:

- një inxhinier i diplomuar në Inxhinieri Ndërtimore me përvojë mund të jetë plotësisht kompetent për ta realizuar kontratën, pavarësisht nëse ka ndjekur apo jo këtë drejtim specifik;
- kërkimi i vetëm një specializimi të caktuar mund të kufizojë konkurrencën, sepse përjashton inxhinierë të profileve të tjera të ndërtimtarisë që kanë të njëjtin ose edhe më shumë përvojë praktike.

Kërkesa për një inxhinier të diplomuar në Inxhinieri Ndërtimore dhe Infrastrukturë me specializim në "Menaxhim të Ndërtimtarisë dhe Teknologjisë" është diskriminuese dhe joproportionale, pasi objekti i kontratës është asfaltimi i rrugës. Për realizimin e këtij lloji të punimeve nuk është i domosdoshëm një specializim i tillë. Punimet e asfaltimit mund të udhëhiqen dhe mbikëqyren nga çdo inxhinier i diplomuar në Inxhinieri Ndërtimore dhe Infrastrukturë me përvojë përkatëse në punimet rrugore. Kufizimi në një drejtim të vetëm të studimeve përjashton operatorë ekonomikë që disponojnë personel profesional me kualifikime ekuivalente dhe përvojë të mjaftueshme në realizimin e kontratave të ngjashme.



12. Një Mjeshtër të Drenazhimit me min.3 vite përvojë pune pas diplomimit.

Kërkesa është e paqartë dhe diskriminuese për këto arsye:

- nuk përcaktohet çfarë nënkuptohet me "Mjeshtër i drenazhimit";
- nuk ekziston profesion apo licencë e standardizuar me këtë emërtim;
- kërkohet përvojë "pas diplomimit", ndonëse nuk specifikohet niveli apo lloji i diplomës.

Për rrjedhojë, kriteri është i paqartë, nuk mund të verifikohet objektivisht dhe duhet të largohet ose të riformulohet te ipet mundësia që të jetë i qertifikuar për Drenazhim.

Gjithashtu, Autoriteti Kontraktues nuk ka përcaktuar mënyrën e verifikimit të këtij kriteri. Nuk është e qartë se cili institucion lëshon diplomë apo certifikatë për "Mjeshtër të Drenazhimit", gjë që e bën kriterin të pazbatueshëm dhe subjektiv gjatë vlerësimit të ofertave.

Objekti i kontratës është asfaltimi i rrugës dhe jo ndërtimi i një sistemi të veçantë të drenazhimit. Autoriteti Kontraktues nuk ka dhënë asnjë arsyetim pse kërkohet një profil kaq specifik. Për më tepër, profesioni i "Mjeshtër të Drenazhimit" nuk është një kualifikim i standardizuar universitar, ndërsa formulimi "me përvojë pune pas diplomimit" është i paqartë dhe nuk lidhet domosdoshmërisht me këtë profesion. Kjo kërkesë krijon kufizim të panevojshëm të konkurrencës dhe nuk është proporcionale me objektin e kontratës.

Po ashtu kërkesat për paisjet e me poshtme nuk janë të domosdoshme dhe nuk janë në përputhshmeri me projektin që dikriminuese dhe favorizuese për ndonjë kompani:

15. Min.nje finisher për shtrimin e asfaltit, max. 5 ton,

18. Min.nje ngjeshes hidraulik që montohet në eskavatore min.1.2 ton (1200 kg)

22. Min. nje kompresor ajri me rrota për terheqje me fuqi - min. 18 bar,

Duke qenë se këto kritere nuk janë të domosdoshme për realizimin e kontratës, nuk janë të arsyetuara teknikisht dhe kufizojnë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë, kërkojmë nga Autoriteti Kontraktues që t'i largojë ato nga Dosja e Tenderit dhe Njoftimi për Kontratë, në mënyrë që procedura të zhvillohet në përputhje me parimet e konkurrencës së lirë, proporcionalitetit, transparencës dhe trajtimit të barabartë, të garantuara me LPP.***Bazuar në pretendimet e cekura më lart i propozojmë s që kërkesën tonë t'a APROVOJË si të bazuar***

## 9. Dëmet materiale

*Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.*

**Dëmtimi tjetër material në humbje kohe duke shfrytëzuar komplet potencialin njerëzor si dhe dëmtim material tjetër siç janë shpenzime administrative .**

## 10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

*Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:*

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.*
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*
- e) bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se,*
- f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe*
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

*\*\*\*Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*